BASHKIA M/
Zyra e Proto...
Nr. 537 Prot.....
Date 5.2.26 Të shkrimi

- STIMP dt 05.02.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE KORÇË – DEVOLL – KOLONJË

Nr. 861/6 Prot. Korçë, më 03.02.2026

Lënda: Kërkesë për publikim.

BASHKISË MALIQ

Brenda kompetencave institucionale dhe tagrit ligjor të garantuar nga Ligji nr.111/2018 „ *Për Kadastrën*", Ligjit nr. 20 dt.05.03.2020 *"Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"* dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1040/2020 " *Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje*" Drejtoria Vendore e ASHK-së Korçë – Devoll – Kolonjë ka miratuar Vendimet për legalizimin e ndërtimeve pa leje në favor të subjekteve të poshtëshënuar.

Në zbatim të pikës 31 dhe 32 të VKM-së 1040/2020 ku parashikohet që " Lista e subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara, shoqëruar me të dhënat e pasurive, si adresa , zona kadastrale, numri i pasurisë publikohet në ambientet e ASHK-së, pranë njësisë së vetqeverisjes vendore, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ASHK-së" dhe " Subjektet e interesuara në përputhje me afatet e përcaktuara në dispozitat e Kodit të Proçedurave Administrative, kanë të drejtë të paraqesin ankim administrativ për vendimin e legalizimit , pranë strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së", për sa më sipër kërkojmë:

- ***Publikimin për afatin 30 (tridhjetë) ditor në ambientet e Institucionit tuaj së listës së mëposhtme të subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara.***

- ***Çdo subjekt i cili ka pretendim apo ankesë në lidhje me vendimin e legalizimit është i lutur ti drejtohet strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së.***

- ***Në përfundim të afatit jeni të lutur të konfirmoni nëse ka apo jo kërkesë/ankesa nga subjektet.***

Bashkëngjitur shkresës po ju vemë në dispozicion:

- Tabelën me listën emërore të subjekteve përfituese ku janë të përcaktuara të dhënat e pasurisë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

DREJTORI

Eni Polena

Eni Polena

Digitally signed by Eni Polena
Date: 2026.02.02 16:31:44 +02'00'

Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore KORÇË-DEVOLL-KOLONJË
Date: 2026/02/03 08:53:13 +02'00'

Adresa: Rr. Maji, Lagjia 18 , Korcë , www.ashk.gov.al, email: info@ashk.gov.al

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë

Scanned with CamScanner

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA V KORÇË - DEVOLL - KOLONJË

ASHK

NR. I VENDIMIT	DATA E VENDIMIT	EMER	ATESI	MBIEMER	NJESIA ADMINISTRATIVE	ZK
46	30.01.2026	ERMAL	JETNOR	MUÇOLLARI	MALIQ	2573

Scanned with CamScanner

- STIMA
- Y. T. Gjinali
dt 05.2.26

BASHKIA MA
Zyra e Proto...
Nr. 538 Prot.....
Date 5.2.26 Nënshkrimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE KORÇË – DEVOLL – KOLONJË

Nr. 861/5 Prot. Korçë, më 03.02.2026

Lënda: Kërkesë për publikim.

NJËSISË ADMINISTRATIVE LIBONIK -

Brenda kompetencave institucionale dhe tagrit ligjor të garantuar nga Ligji nr.111/2018 „ *Për Kadastrën*“, Ligjit nr. 20 dt.05.03.2020 *"Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"* dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1040/2020 " *Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje*" Drejtoria Vendore e ASHK-së Korçë – Devoll – Kolonjë ka miratuar Vendimet për legalizimin e ndërtimeve pa leje në favor të subjekteve të poshtëshënuar.

Në zbatim të pikës 31 dhe 32 të VKM-së 1040/2020 ku parashikohet që " Lista e subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara, shoqëruar me të dhënat e pasurive, si adresa , zona kadastrale, numri i pasurisë publikohet në ambientet e ASHK-së, pranë njësisë së vetqeverisjes vendore, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ASHK-së" dhe " Subjektet e interesuara në përputhje me afatet e përcaktuara në dispozitat e Kodit të Proçedurave Administrative, kanë të drejtë të paraqesin ankim administrativ për vendimin e legalizimit , pranë strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së", për sa më sipër kërkojmë:

- ***Publikimin për afatin 30 (tridhjetë) ditor në ambientet e Institucionit tuaj së listës së mëposhtme të subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara.***

- ***Çdo subjekt i cili ka pretendim apo ankesë në lidhje me vendimin e legalizimit është i lutur ti drejtohet strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së.***

- ***Në përfundim të afatit jeni të lutur të konfirmoni nëse ka apo jo kërkesë/ankesa nga subjektet.***

Bashkëngjitur shkresës po ju vemë në dispozicion:

- Tabelën me listën emërore të subjekteve përfituese ku janë të përcaktuara të dhënat e pasurisë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

DREJTORI

Eni Polena

Eni Polena
Digitally signed by Eni Polena
Date: 2026.02.02 16:31:43 +02'00'
Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore KORÇË-DEVOLL-KOLONJË

Adresa: Rr. Maji, Lagjia 18 , Korcë , www.ashk.gov.al, email: info@ashk.gov.al

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë

Scanned with CamScanner

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VKORÇË - DEVOLL - KOLONJË

NR. I VENDIMIT	DATA E VENDIMIT	EMER	ATESI	MBIEMER	NJESIA ADMINISTRATIVE	ZK
25	30.01.2026	ILIRJAN	NAZMI	DERVISHI	LIBONIK	2445
31	30.01.2026	FOTI	ADEM	GJONI	LIBONIK	2159
48	30.01.2026	ALGERT	SOFOKLI	DURO	LIBONIK	2445
49	30.01.2026	AGRON	YMERLI	VERI	LIBONIK	2445



Scanned with CamScanner

BASHKIA MA...
Zyra e Protokollit
Nr. 339 Prot.
Date 5.2.26 Nënshkrimi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE KORÇË – DEVOLL – KOLONJË

Nr. 261/11 Prot. Korçë, më 03.02.2026

Lënda: Kërkesë për publikim.

NJËSISË ADMINISTRATIVE POJAN

Brenda kompetencave institucionale dhe tagrit ligjor të garantuar nga Ligji nr.111/2018 „ *Për Kadastrën*“, Ligjit nr. 20 dt.05.03.2020 *"Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"* dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1040/2020 " *Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje*" Drejtoria Vendore e ASHK-së Korçë – Devoll – Kolonjë ka miratuar Vendimet për legalizimin e ndërtimeve pa leje në favor të subjekteve të poshtëshënuar.

Në zbatim të pikës 31 dhe 32 të VKM-së 1040/2020 ku parashikohet që " Lista e subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara, shoqëruar me të dhënat e pasurive, si adresa , zona kadastrale, numri i pasurisë publikohet në ambientet e ASHK-së, pranë njësisë së vetqeverisjes vendore, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ASHK-së" dhe " Subjektet e interesuara në përputhje me afatet e përcaktuara në dispozitat e Kodit të Proçedurave Administrative, kanë të drejtë të paraqesin ankim administrativ për vendimin e legalizimit , pranë strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së", për sa më sipër kërkojmë:

- ***Publikimin për afatin 30 (tridhjetë) ditor në ambientet e Institucionit tuaj së listës së mëposhtme të subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara.***

- ***Çdo subjekt i cili ka pretendim apo ankesë në lidhje me vendimin e legalizimit është i lutur ti drejtohet strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së.***

- ***Në përfundim të afatit jeni të lutur të konfirmoni nëse ka apo jo kërkesë/ankesa nga subjektet.***

Bashkëngjitur shkresës po ju vemë në dispozicion:

- Tabelën me listën emërore të subjekteve përfituese ku janë të përcaktuara të dhënat e pasurisë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

DREJTORI

Eni Polena

Eni Polena
Digitally signed by Eni Polena
Date: 2026.02.02 16:31:46 +02'00'
Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore KORÇË-DEVOLL-KOLONJË
Date: 2026.02.03 09:00:34 +02'00'

Adresa: Lagjia 18 , Korcë , www.ashk.gov.al, email: info@ashk.gov.al

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë

Scanned with CamScanner

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA V KORÇË - DEVOLL - KOLONJË

ASHK

NR. I VENDIMIT	DATA E VENDIMIT	EMER	ATESI	MBIEMER	NJESIA ADMINISTRATI	ZK
1	28.01.2026	AUREL	FIQERI	SAPILLARI	POJAN	3952
20	29.01.2026	VIOLLCA	GURADEM	KYCYKU	POJAN	2984
30	30.01.2026	OLTION	THODHORAQ	TRAJKO	POJAN	2902
32	30.01.2026	DURIM	DEMIR	MUÇOLLARI	POJAN	3221

Scanned with CamScanner

BASHKIA M/
Zyra e Proto...
Nr. 540 Prot. .....
Date. 5.2.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE KORÇË – DEVOLL – KOLONJË

Nr. 861/9 Prot. Korçë, më 03.02.2026

Lënda: Kërkesë për publikim.

NJËSISË ADMINISTRATIVE PIRG

Brenda kompetencave institucionale dhe tagrit ligjor të garantuar nga Ligji nr.111/2018 „ *Për Kadastrën*“, Ligjit nr. 20 dt.05.03.2020 *"Për përfundimin e proçeseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"* dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1040/2020 " *Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje*" Drejtoria Vendore e ASHK-së Korçë – Devoll – Kolonjë ka miratuar Vendimet për legalizimin e ndërtimeve pa leje në favor të subjekteve të poshtëshënuar.

Në zbatim të pikës 31 dhe 32 të VKM-së 1040/2020 ku parashikohet që " Lista e subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara, shoqëruar me të dhënat e pasurive, si adresa , zona kadastrale, numri i pasurisë publikohet në ambientet e ASHK-së, pranë njësisë së vetqeverisjes vendore, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ASHK-së" dhe " Subjektet e interesuara në përputhje me afatet e përcaktuara në dispozitat e Kodit të Proçedurave Administrative, kanë të drejtë të paraqesin ankim administrativ për vendimin e legalizimit , pranë strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së", për sa më sipër kërkojmë:

- ***Publikimin për afatin 30 (tridhjetë) ditor në ambientet e Institucionit tuaj së listës së mëposhtme të subjekteve përfituese të ndërtimeve të legalizuara.***

- ***Çdo subjekt i cili ka pretendim apo ankesë në lidhje me vendimin e legalizimit është i lutur ti drejtohet strukturës së posaçme të ankimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së.***

- ***Në përfundim të afatit jeni të lutur të konfirmoni nëse ka apo jo kërkesë/ankesa nga subjektet.***

Bashkëngjitur shkresës po ju vemë në dispozicion:

- Tabelën me listën emërore të subjekteve përfituese ku janë të përcaktuara të dhënat e pasurisë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

DREJTORI

Eni Polena

Eni Polena
Digitally signed by Eni Polena
Date: 2026.02.02 16:31:45 +02'00'
Vulosur elektronikisht nga Drejtoria Vendore KORÇË-DEVOLL-KOLONJË
Date: 2026.02.02 16:31:45 +02'00'

Adresa: Lagjia 18 , Korcë , www.ashk.gov.al, email: info@ashk.gov.al

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë

Scanned with CamScanner

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VE KORÇË - DEVOLL - KOLONJË

ASHK

NR. I VENDIMIT	DATA E VENDIMIT	EMER	ATESI	MBIEMER	NJESIA ADMINISTRATIVE	ZK
14	28.01.2026	ETMONT	HILMI	LUMANI	PIRG	3496
15	28.01.2026	ARMANDI	BEQIR	ORHANLLI	PIRG	3496
24	30.01.2026	TOMOR	BEQIR	ZACELLARI	PIRG	2965
27	30.01.2026	BRUNILD	MELEQ	SHPARTHI	PIRG	3417
36	30.01.2026	SILVANA	KUDRET	KODRA	PIRG	2408
47	30.01.2026	PIRRO	KOLI	KINOLLI	PIRG	3953
50	30.01.2026	ARBEN	HAJDAR	GJONA	PIRG	2965
52	30.01.2026	ASLLAN	XHEVIT	HYKA	PIRG	2965
53	30.01.2026	FUAT	BEXHET	BAKO	PIRG	3496

Scanned with CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
ZYRA E STREHIMIT

Nr. 23 Prot

Maliq, më 5.1.2026

LËNDA: Shpallje publike

SEKTORIT TË IT DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN, BASHKIA MALIQ

NJËSIVE ADMINISTRATIVE, BASHKIA MALIQ

THIRRJE PËR APLIKIM

Për përfitimin e statusit "Pronar Social":

Në zbatim të Ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar, konkretisht nenet 23, 24 dhe 25, Bashkia Maliq fton të gjithë subjektet publike dhe private, të cilët disponojnë banesa dhe janë të interesuar t'i japin ato me qira për familjet në nevojë për strehim, të aplikojnë pranë Zyrës së Strehimit, me qëllim përfitimin e statusit "Pronar Social".

1. **Mund të aplikojë çdo subjekt publik ose privat që:**

a) Ka në pronësi një banesë me dokumentacion të rregullt ligjor;
b) Nuk ka konflikte pronësie mbi banesën;
c) Shpreh gatishmëri për ta dhënë banesën me qira për familjet e pastreha ose në nevojë për strehim.

2. **Subjektit publik ose privat i jepet statusi "pronar social" kur:**

a) banesa e tij plotëson kushtet teknike dhe normat e strehimit në fuqi, referuar raportit të strukturës së njësisë së vetëqeverisjes vendore;
b) qiraja me të cilën ofrohet banesa me qira nuk është më e lartë sesa qiraja mesatare në tregun e lirë;
c) nënshkruan një kontratë me njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku bien dakord për mënyrën e menaxhimit të banesës së tij;
ç) nënshkruan deklaratën se nuk do të refuzojë qiramarrësin për arsye që përbëjnë diskriminim.

3. **Pronari social dhe njësia e vetëqeverisjes vendore nënshkruajnë një marrëveshje e cila parashikon:**

a) afatin e marrëveshjes, që nuk mund të jetë më pak se 3 vjet;
b) masën e qirasë mujore dhe mënyrën e shlyerjes së saj;
c) mënyrën e administrimit të pronës dhe të marrëdhënieve me qiramarrësin.

Scanned with CamScanner

4. Mbështetja e pronarit social:

Pronari social mbështetet nëpërmjet financimeve për subvencionin e qirasë për familjet përfituese. Njësia e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet buxhetit të saj ose me bashkëfinancim me buxhetin e shtetit financon për riparimin e banesës në pronësi të pronarit social, kur vlera e investimit nuk është më shumë se 30% e kostos së ndërtimit të një objekti të ri dhe jo më shumë se 1 000 000 lekë. Në rast se banesa ka nevojë për një vlerë më të madhe investimi, diferenca paguhet nga pronari social në mënyrë të menjëhershme ose me këste sipas marrëveshjes që lidhet midis tij dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore. Kontrata noteriale e lidhur ndërmjet njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe pronarit social, në këtë rast, lidhet me një afat më të gjatë se 5 vjet. Në rast se kontrata prishet në mënyrë të njëanshme nga pronari social, ky i fundit detyrohet të kthejë shumën e investuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore për vitet e ngelura, detyrim ky i cili parashikohet në kontratën e lidhur. Ky detyrim vendoset në kartelën e pasurisë së paluajtshme të pronarit social.

Për çdo informacion mund të paraqiteni pranë sportelit të zyrës së strehimit, bashkia Maliq, apo në email: strehimisocialmaliq@gmail.com.

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

Scanned with CamScanner

STIMP

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
ZYRA E STREHIMIT

Nr. 411 Prot. Maliq, më 29.1.2026

Lënda: Shpallje publike.

SEKTORIT TË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN, BASHKIA MALIQ

NJËSIVE ADMINISTRATIVE, BASHKIA MALIQ

THIRRJE PËR APLIKIM

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ligjit nr.22/2018 "*Për Strehimin Social*", i ndryshuar, VKM nr.384, datë 12.6.2019 "*Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore*", njoftojmë se janë hapur aplikimet për programet e stehimit si më poshtë:

1. Programi "Subvencioni i Interesave të Kredisë" , (kredi e butë) aplikimet janë të hapura në çdo kohë deri në plotësimin e kuotave të përcaktuara;
2. Programi "Subvencioni i qirasë", për vitin buxhetor 2027, aplikimet do të jenë të hapura deri më datë 27.11.2026;
3. Programi "Përmirësimi i banesave ekzistuese për kategori të varfëra dhe të pa favorizuara", për vitin buxhetor 2027, aplikimet do të jenë të hapura deri më datë 28.08.2026.
4. Rastet e emergjencës për strehim përjashtohen nga afatet e mësipërme.

Sqarim:
Në zbatim të ligjit 22/2018 "Për strehimin social", të ndryshuar, VKM mr.384, date 12.06.2019, si dhe Kodit të Procedurave Administrative, aplikimet për përfitim nga programet e stehimit social duhet të jenë të përditësuara dhe të paraqitura sipas procedurave në fuqi vetëm nëpërmjet portalit e-Albania, në hapësirën "Kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social".
Aplikimet e depozituara përpara datës 01.01.2023, pa u formalizuar në sistemin elektronik e-Albania, nuk konsiderohen aplikime aktive për vlerësim.
Për çdo informacion dhe ndihmë mbi mënyrën e aplikimit dhe dokumentacionin e kërkuar, lutemi të paraqiteni pranë zyrës së strehimit bashkia Maliq nga e Hëna në të Premte ora: 08.°°-13.°°

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Scanned with CamScanner

Dosja e çdo aplikanti duhet të përmbajë dokumentacionin që vërteton deklarimet e bëra në fazën e parë.

a) Për të dhënat personale të aplikantit:

i) fotokopje Kartë Identiteti/ Pasaportë.

ii) certifikatë e lindjes së aplikantit, me përjashtim të rasteve specifike kur individi/familja nuk ka regjistrim në gjendjen civile; (e-Albania)

iii) vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkohet strehimi social, për familjet që kanë lëvizur nga zona të tjera të vendit; (gjëndja civile)

b) Për vërtetimin e kushteve të strehimit, sipas shkronjës "a", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":

i) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes "Vërtetim Prone Pozitiv Negativ"; (e-Albania)

i.1) vërtetim për aplikim për legalizim ndërtimi informal; (e-Albania)

ii) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat e strehimit në fuqi; (e-Albania)

iii) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për çdo anëtar të familjes, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi; (e-Albania)

iv) vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se nuk kanë banesë ose nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e pronësisë, të paktën në 5 vitet e fundit; (e-Albania)

v)vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes "Vërtetim Prone Pozitiv Negativ për të gjithë Territorin"; (e-Albania)

vi) aktverifikim nga njësia vendore:

- rastet kur familja ka mbetur e pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore;
- banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit;

vii) Vendim i gjykatës për familjet që humbasin banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës;

viii)akt i verifikimit nga njësia vendore për familjet rome/egjiptiane, që banojnë në banesa individuale ose struktura, të cilat nuk klasifikohen si banesë;

c) Për vërtetimin e kushteve familjare, sipas shkronjës "b", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":

i)certifikatë familjare; (e-Albania)

ii)vendim i gjykatës që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara.

ç) Për vërtetimin e kushteve sociale, sipas shkronjës "c", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":

i)vërtetim i komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar për individë me aftësi të kufizuara;

ii)vërtetim përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezë e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar për individët me statusin e jetimit;

iii) dokument që vërteton se ka mbetur i pastrehë si rezultat i lirimit të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuara;

iv)dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin "emigrant", "punëtor emigrant" dhe "azilkërkues";

v)dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të shtetit dhe të Policisë së Burgjeve;

vi) urdhër mbrojtjeje apo urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje, lëshuar nga gjykata për viktimat e

Scanned with CamScanner

...ë familje;
...) vetëdeklarim nëse individi/familja i përket pakicës kombëtare rome ose egjiptiane;
viii) dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin;
ix) vetëdeklarim se i përket grupimit LGBTI;
x) vërtetim me certifikatë familjare se individi i përket kategorisë vajzë-nënë. (e-Albania)

d) Për vërtetimin e kushteve ekonomike, sipas shkronjës "ç", të nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social":

i) vërtetim i të ardhurave neto të familjes ose një deklaratë me shkrim nga aplikuesi për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, të cilat duhet t'i bashkëlidhen dokumenteve zyrtare që e vërtetojnë atë, përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune; (e-Albania/punëdhënësi)

i.1) vërtetim kontibutesh për individin për personat e familjes që janë në marrëdhënie pune; (e-Albania)

ii) dokument nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për të gjithë anëtarët e vetëpunësuar të familjes; (e-Albania)

ii.1) vërtetim xhiro për 3 vitet e fundit dhe vërtetim të ardhurash nga biznesi; (e-Albania)

iii) vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar; (e-Albania)

iv) vërtetim nga zyra e punësimit e njësisë vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë; (e-Albania)

v) vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension; (e-Albania)

vi) vërtetim toke për të gjithë personat të lindur para vitit 1992; (Njësia Administrative)

vii)vërtetim nga organet tatimore për aktivitet privat "Vërtetim për individ të pa rregjistruar" (e-Albania)

vii) vërtetim për personat e rregjistruar si punëkërkues të pa punë. (e-Albania)

viii) vlerësim social ekonomik nga zyra e shërbimeve sociale (Njësia Administrative).

- **Dokumenta që kërkohen vetëm për aplikantët e programit për përmirësimin e banesave ekzistuese, në rrezik shëmbje/të amortizuara:**

i) Dokumenti i pronësisë së objektit (çertifikatë pronësie/lejë legalizimi);
- Në mungesë të Certifikates se pronesise te sillen dokumentat si më poshtë:

ii) Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP);
iii) Certifikatë familjare 1991(e-Albania);
iv) Vërtetim mbi pronësinë e banesës (form 01) ku të specifikohet nëse familja është banuese në këtë njësi apo jo (Njësia Administrative);
v)Fotokopje të listës së trojeve (form 01)ku figuron banesa e aplikantit(Njësia Administrative);
vi) Vërtetim nga formulari 06 (listë pronash që vërteton AMTP) (Njësia Administrative);
vii) Foto të banesës në rrezik shëmbje/të amortizuara, ku evidentohen dëmtimet në prani të familjes (brënda/jashtë dhe të gjithë objektit);
viii) Këkesë me shkrim e familjes (duke përshkruar gjëndjen e objektit) për banesat në rrezik shëmbje/të amortizuara dhe arsyen pse nuk mund ta riparojë vetë familja;
ix) Aktverifikim nga njësia vendore për banesat në rrezik shembjeje/të amortizuara; (Njësia Administrative);

Sqarim:
- ✓ Dokumentacioni që kërkohet është në varësi të programit të strehimit për të cilin paraqitet kërkesa, si dhe kushtet e strehimit apo social-ekonomike të aplikantit.
- ✓ Dokumentacioni mbi vërtetimet e pronësisë dhe kushtet ekonomike kërkohet për të gjithë pjesëtarët e familjes me moshë mbi 18 vjeç.

Scanned with CamScanner